

Periodical satiric magazine / Year I / No.1

Ferizaj, January 1<sup>st</sup>, 2024

# HITHI



# ESH




## THE BEGINNING OF CARTOONS IN KOSOVA

*Interview with cartoonist  
Ramadan Zaplluzha - "Therrë Murrizi"*

## QUZA'S TIKTOK

## THE WORLD THROUGH EFFAT'S EYES

*Written by Fawzy Morsy*



## TRACES OF KOSOVAN SATIRE

©2022 Paul Palushi, Michigan-USA

**Publisher:** Shoqata e karikaturistëve HiTHi (*eng: Association of cartoonists HiTHi*)

**Director:** Imri Musliu

**Coordinator:** Besnik Rrustemi

**Collaborators:** Afrim Demiri & Feriz Musliu

**Translator:** Fadil Bajraj

**Editorial office:**

Imri Musliu

Skender Demolli

Abdyl Hajredini

Supported by:



REPUBLIC OF KOSOVO  
Ministry of Culture,  
Youth and Sport



REPUBLIC OF KOSOVO  
Ministry of Foreign Affairs  
and Diaspora



MUNICIPALITY OF FERIZAJ

# WELCOME TO OUR LIFE “HiTHi QESH” MAGAZINE

Not long ago, Imri Musliu, an author already known for his humorous and meaningful cartoons, in Kosovo and abroad, told me that the time has come for the Association of Cartoonist of Kosovo, HiTHi Kosova Cartoon, to have its own magazine, for the fans of sketches, comics and humor, to have as a pocket exhibition. Brilliant idea, moreover, humor in general and cartoons in particular are so in demand and there is no popular media in the world that does not have these works as daily guests, because on their pages there is more light and flavor of democracy, as well as more boldness. And I kept silent and thought about that. As the initiator and President of this Association Musliu and others, but also me as its member and author of humor, I thought I was dealing with a puzzle: Can something valuable come out of it? Yes, but, let's wait a little bit longer, I said to my friend and then I remembered someone's advice: "If you really feel your inner need to do something, sit down once, take a deep breath and wait until the urge passes." The desire related to success, gaining the interest of readers, viewers, the staff who will support this traveling exhibition of "nonsense" let's call it for the sake of subject matter and content. There is as much material in life as you want, even in abundance, because it is known that "stupidity manifests itself at every level, in every person, in every age." And in the meantime I remembered the tradition of our Albanian guest parlors, with "wisecrackers", or with riddles about the topics of the day, "what is good, what is bad, or what is neither good nor bad in life. Whoever did not understand these topics was killed by evil slowly, like the Sphinx during his lifetime, like someone condemned to torture. But if someone has understood, then the next stupidity destroys itself, and the self-understanding is saved and is blissful and happy...You, therefore, keep in mind not to become paranoid about what I am telling you." (Kevis Thiveas, second century. AD.)

Access to tradition, myths and legends is fruitful. But one should speak with "witticism", or without



words, only with an icon as in a caricature, where the truth is imprinted, but expressed with emotions, so that between it and the pleasure of art, the message is conveyed naturally. Both immortal myths and similar creations show that fantasy is an endless river and that the way of expression though it is characteristic of all arts. And if you take a closer look at the creativity of Kosovar authors, in all genres, it would turn out to be an unusual encyclopedia. Even in the HiTHi, which, to make sure there is no confusion, this coming year celebrates the 6th anniversary with a success story at the Cartoon Salon in the country and abroad, with so many authors who have already

created their profiles in this difficult genre and are on the way to success, even awarded for their works at international competitions and Humor Festivals, such as recent prestigious Award of the president of this Association, Mr. Imri Musliu, for a caricature, at the National Competition for Satire and Humor "Niko Nikolla" for the year 2023, which has just ended with its Humor festival and annual HiTHi exhibition in Ferizaj. Of course, the number of icons in polyfoto HiTHi Cartoon Kosova will be bigger and bigger, with new talents and authors, who have natural sense of laughter and passion...The passion to enrich it more and make a more beautiful mosaic for them with creativity from everyday life, which its pioneers have already started, giving it is special stamp not only in Ferizaj and Prishtina, where this source of laughter began to flow, but also in cultural events in Tirana, Pogradec, Korça, Skopje and other neighboring countries of the Balkans, where the cartoon invites and attracts as if by magic with its direct messages about socio-political and economic life, family, people everywhere in the world today with endless wars and troubles, feeding above all with thoughts and ideas for action. In general, the exhibitions of

this already consolidated Association, as shown by the catalogs in which the authors participate, were also due to major global themes that were in some way dictated by the often specific time, because such as those for ecology and the relationship of man to the environment, human rights to opinion and freedom of expression, inequality in any form, especially towards women and people with disabilities, dealing with the Covid pandemic and the age-old pandemic of stupidity in all its struggle and corruption, local wars such as the one in Ukraine and recently in the Middle East, which with the nuclear threat have become a serious threat to nations striving for peace on the planet, etc. Exhibitions where, using the classic weapon of satire and humor against evil, the creators tried to express their opinions and attitudes freely with a pen on white paper, for every problem of life and its development, with creative imagination and further improvement of their creative method. Because of this, many authors, as I have already mentioned, were and are quite popular among public.

Then when we have success, what are we waiting for?... Let's sharpen the mind and the pen and say to this special magazine: "Welcome to our world of laughter! A world that loves you, but when you deserve it, it punishes you!" Let's think for a moment about the liberation and relief that it will bring to people through humor on its printed pages and social network.

Laughter offers friendship and on its way, this swallow is not only black and white, but also with that red summer thread, which people give as a gifts in the spring, hoping that it will bring them kindness and joy for their dreams, to feel through the sense of laughter filled with strength and victory in the difficult moments of his life, he will gain even more friends. And tomorrow "HiTHi Qesh", will be a rare collection between the traditions of country's civilization and culture of the people. Because as former NBC executive Pat Weaver says, "Laughter is a social experience, not a personal one." Nobody likes to laugh at themselves. When you are sitting in your living room, a sincere "canned laughter" immediately puts you in the mood of the public, even in the best place, to enjoy the pleasure of entertainment."



*WELCOME TO HITHI KOSOVA CARTOON, WITH THE NEW MAGAZINE HITHI QESH! GOOD LUCK!*

## Imri MUSLIU

Edhe në situatat më të vështira kur shkilen të drejtat më elementare të individëve e grupeve, nga individë, grupe, pushtete totalitare apo tjerë, por edhe në rast të katastrofave natyrore, përherë, për t'u përballuar më lehtë me dhembjen e hidhërimit, e përdorim humorin e satirën, jo për të hequr dorë nga ballafaqimi me të keqen, por thjesht duke e luftuar atë në një mënyrë tjetër, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi.

Nuk jemi HiTHi Kosova Cartoon E – Magazine të vetmit që përmes humorit e satirës do ta injorojmë të keqen e do të mbjellim shpresë për ditë më të mira, por do të jemi një gur më shumë në mozaikun e madh të revistave të humorit e satirës të cilat sjellin shpresë dhe freski në zemrat e njërëzve që pësojnë nga rrethi të cilit i takojnë.

Nuk janë vetëm luftërat e fatkeqësitë natyrore që na e ngarkojnë jetën por edhe mediat e paguara që na ofrojnë lajme të rreme, nga më të ndryshmet, për t'i arritur qëllimet e atyre që u shërbejnë.

Artistët dëshmojnë përmes artit, se janë shtresë elite e shoqërisë, duke përçuar mesazhe sa më të qarta për problemet me të cilat ballafaqohet shoqëria e jo duke iu bërë krah atyre që bien ndesh me vlerat e dëshmuara njerëzore!

HiTHi Kosova Cartoon E – Magazine do të bashkëpunojë me të gjithë krijuesit që i luftojnë dukuritë negative, kudo që paraqiten ato. Për të tjerët nuk do të ketë hapësirë në faqet e kësaj reviste.



*Even in the most difficult situations when the most basic rights of individuals and groups are violated by individuals, groups, totalitarian authorities or others, but also in case of natural disasters, always, to cope more easily with the pain and bitterness, we use humor and satire, not to give up on facing evil, but simply to fight it in a different way, directly or indirectly.*

*We HiTHi Kosova Cartoon E – Magazine are not the only ones who, through humor and satire, will ignore evil and sow hope for better days, but we will be another stone in the great mosaic of humorous and satirical magazines that bring hope and freshness to the hearts of those who suffer from the circle they encounter.*

*Our lives are not only burdened by wars and natural disasters, but also paid media that offer us fake news, of the most varied, to achieve the goals of those they serve.*

*Artists prove through art that they are the elite layer of society, conveying the clearest possible messages about the problems facing society, and siding with those that contradict proven human values!*

*HiTHi Kosova Cartoon E – Magazine will cooperate with all creators who fight negative phenomena, wherever they appear. There will be no room for others on the pages of this magazine.*

## THE BEGINNING OF CARTOONS IN KOSOVA



*Interview with cartoonist Ramadan Zaplluzha – Therrë Murrizi in the spaces of the Tourist Complex Bifurkacioni in Ferizaj, who passed away on July 13, 2020, at the age of 82. (Cellphone video recording, 9 minutes and 24 seconds, June 17, 2018). The interview was conducted by Imri Musliu.*

Imri Musliu:

- Can we talk about the cartoon starting with Aqif Kajmakçiu?

Ramadan Zaplluzha:

- I knew Aqif personally before 1958. In 1958, the newspaper Rilindja (around the November holidays) became a daily newspaper. Until then, it was a weekly newspaper.

Imri Musliu:

- When did you start to draw for Rilindja? While it was a weekly newspaper or after it became a daily newspaper?

Ramadan Zaplluzha:

- Even before it became a daily newspaper, I published all kinds of drawings in Rilindja, on the children's page. I published in Zani i Rinisë

in 1954, when that newspaper was prepared by Albanian students studying in Belgrade.

They were lovers of different arts and started publishing a newspaper for young people.

They chose a very old journalist, a very good and well-known journalist, Masar Murtezai, as the responsible editor in chief. I knew Aqif and Masar well, because Aqif and Masar were very close friends. Masar knew and found Aqif as a cartoonist, and when Rilindja was published in November 1958, on the occasion of the holidays, Aqif was chosen as a cartoonist in Rilindja. While Rilindja was still a weekly newspaper, I published a real caricature and it was about Rahovec wine that was bought the most by trade organizations of alcoholic beverages in Slovenia. Here they found it cheap and sold it twice as much. I presented this in a cartoon.

Imri Musliu:

- Do you remember when Aqif publish the first cartoon?

Ramadan Zaplluzha:

- I know of no other published cartoon of Aqif, until Rilindja began to be published as a daily newspaper, when Anza published cartoons once a week, and then he was a journalist of the daily newspaper Rilindja, more precisely a journalist of Anza. Aqif published cartoons in Anza, cartoons with humorous text, which are also called "rrokopenla". Especially Aqif's texts were very witty because he wrote them in his own hand in the Albanian language, and Aqif Kajmakçiu's Albanian was full of Turkism. Although he was Albanian, he spoke Turkish. Just like in Prizren, they are usually Albanians, but they also speak Turkish. Ismail Qemali also spoke Turkish. Even Sami and Naim who lived in Istanbul or others in Prizren, talked Turkish. Because Aqif's father graduated from the School of Visual Arts, Middle of High School of Visual Arts in Istanbul. He returned here and was a teacher in Prizren, but was fired from his job in 1951 or 1952, when the question of Turks (statement of nationality – I.M.'s remark). He said, "I am Albanian! Why I speak Turkish, it doesn't matter at all!"

Imri Musliu:

- Aqif's father was fired just because he said, "I am Albanian?!"

Ramadan Zaplluzha:

- "I am Albanian!" he said. "I can't become a Turk and teach you in the Turkish language!" Aqif wrote texts in Albanian with a lot of Turkism and he became quite funny, and people liked it. Even Anza in Rilindja was like that, for humor and satire. That's all I know about him. I wrote two pages about Aqif in the newspaper Fidani, after the war. From 1954 until today, I published my works. Not only cartoons, but something "sort of" comics (allegedly like a comic book) in Rilindja and in Pionieri... In fact, in Pionieri it was a story without words: a drawing, another drawing, and then another... This was a "sort of" comic book, without text, but read like a comic. The comic comes out very late. In 1959, I published a comic in Pionieri, which I luckily found in Rilindja, from



1959-1960. It was published in sequels and the main character is a folk hero of that time. I was in the army when I got royalties for that comic. I have a photocopy of that comic that I got from the Central Archives of Kosovo. It was published in Pionieri in 1959.



# LAJME NGA QYTETI

1/ Qyteti i Ferizajit u njoh si qytet i hekurudhës, se hekurudha e bëri qytet. Më vonë ajo u bë pengesë, se e ndau qytetin në dysh. Tani kur filloi projekti „Bashkimi i Qytetit“ janë bërë tunele të shumta që i ngjajnë një livadhi që e kanë gërryer urithët, por këtu ka një dallim. Urithët krijojnë grumbuj dheu mbi sipërfaqe, e tunelet kanë krijuar gropa të rrethuara me parmacë.  
Tani shtrohet dilemma: Ferizaji është qytet i hekurudhës apo i tuneleve?

2/ Udhëheqësia komunale e qytetit u ngut pakëz kur hapi tunele për qarkullimin e automjeteve, se tani për ta shmangur trafikun e dendur mund t'i përdorim dronët!

3/ Deri më tani njerëzit ankoreshin se nuk kishin parkingje të bollshme për vetura. Me hapjen e parkingjeve nëntokësore u zgjidh ky problem, por tani mund të ketë ankesa, se veturat qëndrojnë nën hije e njerëzit në diell, në ditët me vapë!

4/ Në Sheshin “Ramadan Rexhepi” nuk ka qarkullim as kushte për t'u ulur njerëzit për të pushuar, se nuk ka hije as ulëse. Për ta mbushur këtë shesh me njerëz, mjafton të instalohet Wi-Fi gratis, dhe njerëzit do të merrnin shilte e sexhade me vete dhe do të qëndronin aty tërë ditën!

5/ Thuaja në të gjitha muzetë e botës hyhet me pagesë për t'i parë eksponatet e vendosura, kurse te ne, le që nuk ka shumë vizitorë, por shpesh shkollat dërgojnë nxënës për ta përmbushur një shifër modeste të vizitorëve.  
Nuk e di përse nuk ka më shumë vizitorë, kur aty ka lesa me ferra, parmenda të drurit, zgjedha për kafshët tërheqëse etj.?!  
VITI I RI 2024

6/ Bifurkacioni simbolik te sheshi “Ramadan Rexhepi”, ngjan plotësisht me Bifurkacionin e vërtetë në lumin e Neredimës. As njëri nuk ka ujë!

Kismet, me t'parin t'parit 2024, po ja therrim edhe na për Evropë!  
- Pata me ardhë, po Lybetenin sun e la vet!



# TRACES OF KOSOVAN SATIRE

*Humoreskë*

## NUSJA KA TË SHKELUR

Heli sapo ish martuar. Vishej me rroba solemne, vënte kollare, shëtiste e bisedonte me fshatarë dhe gjithëherë ishte i buzëqeshur. Dhe kishte arsye. Nusen e kishte marrë të bukur dhe për qejfi. Para pak kohësh kishte marrë edhe titullin profesor, pas plot shtatë vjet studimesh. Po kjo nuk kishte rëndësi. As ajo që Heli kish nja tre profesorë të njohur dhe e ndihmuan, s'ka rëndësi. Bezbeli, miqtë për ndihmë janë.

Nusja ishte e bukur dhe shumë e re, po Heli nuk e kishte parë deri natën e martesës. Megjithatë ai ishte shumë i kënaqur. I bëhej sikur ishte gazmuar edhe shtëpia, edhe oborri. Të gjitha. Po kjo nuk zgjati shumë. E mira dhe e liga nganjëherë sikur rrinë bashkë. Nusja nisi të ankohej se kishte dhimbje koke dhe marramendje. Heli menjëherë e çoi te mjeku. Ato pak ilaçe që ia dha mjeku, nuses nuk i bënë dobi. Prindërit e Helit mendonin se nusja ishte për hajmali. Ata e zunë ngoje Mulla Kurtin e Plepishtës, që ishte hoxhë i dëgjuar për punë të tilla. Po Heli, si professor, njeri i shkencës që ishte, nuk iu bind menjëherë idesë së prindërve. Ai e bëri veshin të shurdhër ama mendjen e kishte te Mulla Kurti. Kaloi një javë. Kaloi dhe një muaj e nusja vazhdimisht ankohej.

Pale, mendoi Heli një natë. Nuk është keq që të shkoj te hoxha. Sehuret janë hak. Ato edhe shkenca i pranon. Nuk dihet ku e ka ilaçin njeriu. Biles, mjeku më së paku di për sëmundje të tilla, erdhi në përfundim Heli. Për fat të tij, sapo u zgjuan, nëna sikur e kishte kuptuar mendimin e tij, ndaj iu lut:

- Hel biro, merre nusen e shko te hoxha, pashë nanën! Nuk është edhe aq larg. Mulla Kurti sehuret i prish me kaull. Aty shkojnë prej kahmosit. Nga të katër anët e dynjasë, iu lut plaka të birit.

- Hajt nënë se po ta bëj qejfin e po shkoj, iu përgjegj Heli të ëmës dhe mori nusen e u nis. Kur

hynë brenda, hoxha i kërkoi Helit që të ulej në gjunj, mu aty para tij dhe pa një pa dy ia priti:

- Çafir! Edepsëz! I pa fe...çirrej Mulla Kurti, si të ish i krisur. Heli i bëri sytë katër dhe nisi të dridhej si gjeji në ujë.

- E ke marrë me qafë këtë filiz. Nusja moti u kanë për mue. S'i ke ra mas robit tan. Sikletin qi e ka kjo, toka nuk e man, foli hoxha gjithë ters dhe pa u ndalur.

- Paj punët nuk po lëshojnë bre aga hoxhë, u përpoq të arsyetohej Heli.

- Psssst, ia bëri me gisht ai dhe Heli nuk e zgjati më shumë. Mandej hoxha mori një letër të bardhë dhe zuri ta shikonte gjoja me kujdes, sikur aty të shihte gjithë sikletin që kishte nusja.

- Nusja ka të shkelur, foli bindshëm Mulla Kurti. Ka shkel pas darke në vend të lig, pas shpie, te gardhi, sqaroi më tej ai.

- A ka shkel nusja edepsëz, iu ngermua Helit hoxha.

- Po...aaa...aga hoxhë, mezi belbëzoi Heli. Do të shkreta dru i kemi atje mbas shtëpie te gardhi, mu aty ku po thua se ka shkel kjo fatzezë, e pohoi Heli, duke bërë me dorë andej nga nusja.

- Do të bëhet mire, premtoi Mulla Kurti, duke e parë Helin aq të mallëngjyer. Mandej zhgarraviti diçka në fletën e bardhë dhe atë e bëri hajmali. E thirri nusën pranë dhe nisi t'ia fërkojë ballin, qafën e gjoksin, duke ia thënë 101 fjalë përkëdhelëse, si "kulli i zotit", "melaqja e perenisë", "pllumi i bardhë", "hyria e xhenetit" e të tjera, të cilat nusja mezi i duronte. Ai, pastaj hajmalinë ia dha nuses dhe i tha që atë ta puthte tri herë, gjë që nusja e bëri me shumë mundim. Hajmalinë, me urdhërin e Mullait, me kënaqësi e puthi edhe Heli.

Në të dalë, Heli ia lëshoi hoxhës një njëmijëshe në grusht, iu falenderua me zemër dhe çau për në shtëpi, i kënaqur e i dalldisur.

Po nuses hajmalia nuk i bëri dobi.

**Gani Bytyçi**


*Kjo humoreskë është botuar në revistën mujore për arsim SHKËNDIJA më 07. 11. 1985*



Agim Krasniqi

Agron Sejdiu

# LIFE *in* KOSOVO



Agron Sejdiu



Agron Sejdiu




Anil Jashari




Binjamen Haxha




Bujar Qeriqi



askush mbi ligjin !



Driton Kastrati




Effet





Driton Kastrati




Fatmir Buq




Gëzim Pozhegu





Imri Musliu

Luljeta Goranci



PRITA BERE QET, MË DOHË RËFKET !




**Meri File**



**Nexhmedin Hasani Trisha**



**Selajdin Hajdini**



**Selajdin Hajdini**



Shpend Kada




Shpend Kada



Uran Limani

By Fawzy Morsy, cartoonist/Egypt

## THE WORLD THROUGH EFFAT'S EYES



He is a distinguished artist, who has an unusual view with a wide imagination, he undoubtedly has his own unique approach in the art of caricature, Effat devoted his Rebellious brush to express the dreams and needs of the lower class, ensuring his clear bias towards them, when we consider his work, we realize how attached he feels to the Egyptian quarter/district. His drawings are simple but very rich both on the color and human level, impressive, pulsing with spirit and life, in his paintings you can almost see the sound and hear the color, and through his works of art you see the amazing and charming Egypt through his eyes.

Cartoonist Mohamed Effat was born in 1948, in Shubra district, which is one of the largest districts in Cairo Governorate. Effat began his artistic career drawing cartoons while working for

the Akhbar-Elyoum newspaper. His drawings have been published in various publications of Akhbar Elyoum Foundation, including Akhbar ElAdb magazine, and Akher Saa'a magazine.

Nusf al-Dunya magazine, published by Al-Ahram Foundation, has used some of his cartoons for several years. Effat also drew cartoons for children in the Kuwaiti magazine Al-Arabi Al-Saghir. His cartoons have been published in many international newspapers and magazines. He also collaborated with the American cartoon magazine Witty World.

Effat was a spontaneous artist who believed in his message and the questions of his art, to which he devoted his creative energy. Effat did not marry and lived alone, he loved and remained faithful to the art of caricature, thinking about it day and night, drawing his dreams and his imaginary world, he drew silent caricatures, without words or comments, and this is one of the most difficult types of caricatures, because it is the only common language for all countries of the world. It transcends geography and borders, and is easily accessible to the recipient, and he always said that caricature is not a joke just to make people laugh, but it is a human art that deals with entertainment, meditation and philosophy, which includes a message and a goal that must be conveyed to people with few words, and he used to say: "A good cartoonist must be a visual artist, but I don't paint visual pictures. I draw caricatures with a visual sense. There is an interest in mass and space, in the distribution of color and harmony within the work, but there is always an idea of caricature.

Effat founded a branch of the Federation of International Cartoonist Organizations in Egypt, known as (FICO), in 1996, which played a key role in bringing Egyptian cartoons to the world, and he served as president until his death.

Effat was an ambassador of Egyptian cartoons abroad, since he is the first Egyptian artist who managed to shed light on Egyptian caricature and present it to the world, through the Pharaohs Cartoon Magazine, which was a digital magazine published monthly in Arabic and English. Effat has published a magazine to connect with various countries of the world.

Effat dealt with folkloric life in Egypt and was interested in drawing Egyptian areas in all details, including houses, mosques, churches, crowded open markets, cafes, and children on the streets playing their popular games, through his lines and colors that are placed in musical harmony, where he can create a visual rhythm that penetrates the spirit, conscience and feelings of the viewer. Effat was interested in the culture and heritage of different peoples around the world, he organized many exhibitions that dealt the folklore of some countries of the world by drawing cartoons through his eyes, and participated in hundreds of cartoon exhibitions in Egypt and various countries in the world, including Cuba, Brazil, South Korea, Japan, Belgium, France, Germany, Spain, Bulgaria, Portugal, and Kuwait, and represented Egypt as an arbitrator at many international competitions and exhibitions.

He won many national and international awards, one of the most significant being the bronze medal in the Daejeon International Cartoon



Contest in South Korea in 1999, and the gold medal in the International Comic Caricature Contest in Japan in 2004. He was honored at the 5th International Cartoon Gathering in Cairo in 2018, and he recently won a special prize in the Cartoon Contest. Daejeon International Cartoon in South Korea in 2019, but he died before receiving it.

## Gallery Of Cartoon By Mohamed Effat - Egypt



Skënder DEMOLLI

## DON KISHOTI GOMARI I SANÇOS DHE GALLOFI

Një ditë Don Kishoti dhe shërbetori i tij besnik Sançoja, ishin unjur e po shplodheshin nën hijen e një lisi të moçëm, sa edhe kjo histori e shkurtër, të cilën Servantesi i madh, harroi të na i rrëfejë, në librin me aventurat e tij të famshme.

Gomarin e kishte vrarë keq samari, për këtë Sançoja ia kishte hequr atë nga shpina dhe e kishte lidhur të freskohej pak më tej, pranë një shkëmbi nga prehri i të cilit buronte një gurrë e pashtershme ujëftohtë. Një gallof i kishte qëndruar mbi kurriz kafshës së vojtur dhe e çukiste pa mëshirë, në plagën e krimbur.

Befas Don Kishoti bërtiti i ngazëllyer, duke i treguar Sanços atë që kishin para syve...

- Ç'pati që kërceu ashtu përpjetë i rëmbyer

Kalorësi i Fytyrës së Vrerosur, - i tha gallofi gomarit?... - Ty po të çukas, atij i dhemka kurrizi?!... Ç'po i thotë ashtu me duar e me këmbë tët zoti?

- Një pamje e rrallë, Sanço!... Një pamje fantastike që Babai i Perëndive dhe njerëzve Zeusi, e shfaq ta shohim vetëm ne të dy, - zuri t'i thotë fjalë për fjalë gomari gallofit, ato që dëgjonte nga goja e Don Kishotit.

- Prometeu i lidhur!... Jo Prometeu i rremë i tragjedisë së Eskilit, por Prometeu i vërtetë: biri i titanit Japet dhe i Klimenës, vëllai i Atlasit dhe i Epimeteut. Ai Sanço, që shkoi te Qerrja e Diellit, vodhi një shkëndijë të cilën e fshehu, në kërcyellin e një kallami dhe pasi u kthye në tokë, ua dha këtë



burim të zjarrit hyjnor njerëzve.

I zemëruar, siç dihet Zeusi vendosi të hakmerrej kundër të vdekëshmeve të Prometeut. Në fillim ai dërgoi Pandorën, e cila përhapi të gjitha fatkeqesitë në tokë, duke hapur kutinë e saj fatale, që solli, si dhuratë... Kutia e Pandorës, ke dëgjuar të thonë?! I nëntëmbëdhjeti doli prej saj mbi dhe Kovid, po dhe sa pandemi të tjera do të dalin!

Pastaj urdhëroi Hefestin që ta lidhë Prometeun në malin e Kaukazit, ku një shqiponjë, jo nga ato shëmbëlltyrat që bëjnë me duar sot nëpër stadiumet e botës lojtarët e Arbërisë pas golave, do t'i coptonte ditë e për ditë mëlcinë që i rritej përsëri natën. Ja, ku e kemi Sanço para syve, shenjtorin dhe martirin, vetë - Prometeun.

- Kra!...Kra!...Kra!... Po, nuk më thua, kush është Prometeu këtu, - pyeti gallofi gomarin, që dukej më i mençëm nga i zoti i tij.

- Akoma nuk e paske marrë vesh?!...Prometeu në fantazine e tij, jam unë Veshgjati i lidhur pranë këtij shkëmbi.

- Promete një gomar?!...

- Pse jo, kur na gjen edhe më lart nga ky mal?!

- Paska rrjedhur fare Hirësia e tij, kur fantazon Promete një gomar!...

- ... dhe shqiponjë një gallof, si ti, - palli gomari! –

A! A! Aaa!..

- Pse ashtu thotë?...

- Ashtu vërtet!

- Ua! Po, qënka goxha mendjendritur ky Kalorësi i Hekurt, - e ktheu fletën gallofi dhe u fry i tëri, si shqiponjë!

- E pse tani, na qënka mendjendritur, - vërejtë gomari?!

- Sepse drita është e mirë, kur ndriçon të mirën.


Pa, mendo: një gomar Promete dhe një gallof shqiponjë!

- Ajde, leri trillet e më qëro krimbat nga plaga, - ia futi me bisht gallofit!

Po, ndërkohë Don Kishoti që ngritur në këmbë dhe po i kërkonte Sanços shpatën dhe mburojën.

- Ç'ka ndërmend të bëjë ashtu, - pyeti gallofi i tmerruar, kur e pa të sulet me yrysh drejt tyre?

- I shëmbellen vetja Herkul dhe do të vrasë shqiponjën, të çlirojë Prometeun, - e sqaroi veshgjati. Po, ndërkohë gallofi kishte fluturuar, duke lënë Don Kishotin bashkë me Sançon e gomarin, në peripecitë e tij të perjetëshme.



Thoma GOGA

## "STANIN E MADH" PO E HA "MOLA" ...

- Nga defteri Çeços -

Në stanin e vogël të Çeços punët shkojnë për bukuri. "Sahat", siç thotë populli. Aty ka punësuar një afgan, një kinez, një irakian dhe presin të vijnë ca afrikanë. Afgani Kali Misir ka mësuar më mirë shqip. Kafsharët vendas i mbajnë afër muhaxhirët. Dje Çeçua kaloi për kontroll "të befasishëm" nëpër stan. Kinezi po "luftonte" me një zhapik, kurse irakiani dhe afgani nuk dukeshin.

- Ç'të ka bërë zhapiku që e ndjek, o mavri?- i tha kinezit.- Po sikur të ishte ti zhapik, do të vinte mirë të shtija unë me gurë?

- Hai. Ok. Xing fu në tigan për drekë,- u përgjigj kinezi.

- Ore kinezaxhi, lëre zhapikun në vendin e tij, se ndryshe të ndoqa në Peqin.

- No, no Peqini elbasançe. Jam Pekini i Qinës së madhe...

- Qofsh me shëndet, o qinez, - ngriti zërin Çeçua.

- Ke ardhur si mik e rri si mik. Mos u merr me një zhapik, po hap defterat të mësoç shqip. Nashti u graduam si "akademi". Ka rregulla e "dhisiplinë" këtu në stanin tim. Do t'u marrë në provim. More vesh? Mora, thuaj.

Si bëri ca hapa, Çeçua gjeti irakianin që ruante dhinë, duke luajtur me qenin.

- Dëgjo këtu, o nipi Sadamit. Mos ma lodh Murrin! Nuk lejoi të shkelen të "ndrejtat" e zagareve. Për të "ndrejtat" e njeriut, nuk mbaj përgjegjësi... Prandaj shiko dhinë dhe mëso shqip. More vesh? Mora, thuaj. Po nuk kalove provimin, do të vë ty në vend të qenit.

Pak më tej gjeti muhaxhir afganin te kolibja e tij. Po shkruante në një defter. Ai dhe ca kafsharë të tjerë kanë pushimin e drekës.

- Ç'po bën, o Kalli? Eja mo, eja këtu në bythë të fiqëve, - tha shefi stanit dhe çoi mbi kadishte ca djathë, gjizë, turshi dhe një faqore raki.

- Unë kujtime shkruaj nga lufta e mësoj gjuha jote. - Shumë mirë bënë. Ta mësoç gjuhën tënë, se për atë kanë rënë shumë patriotë,- vazhdoi Çeçua dhe

i hodhi në gavetë pak raki.

- No, no unë vetëm "lalë" pi.

- Birinxhi mirë! Ju muhaxhirët po ma kurseni rakinë. E po, merre gavetën tjetër me dhallë. Hajde gëzuar ! Më rruaç e të paça!...

- Ejvallah! Edhe ti të ma rruash...,- u përgjigj afgani, që nuk i njeh fare këto adete.

- Do mësoç mirë shqip, apo...,- ja ktheu Çeçua - Mos më thuaj "të ma rruash". Unë nuk ta rruaj, po ta pres fare e të bëj prapë synet...More vesh? Mora thuaj, lanet !

Kështu kaloi me shaka edhe ky keqkuptim. Meqë ishte pushimi i drekës, Çeçua thirri dhe kafsharët e tjerë. Me këtë rast kaloi radhën e "informacionit politik".

- Dëgjoni këtu ju kafsharët e mi,- nisi kuvendimin shefi i stanit.- Rrogat do ua rris kur të mësoni edhe një gjuhë të huaj. Nashti u bëmë "stan ndërkombëtar", kupton apo jo. Le ç'thotë ai "i gjati". Të shikojë ata patronazhistët e shtetit, që bëjnë koqen e qejfit...

- Po mësuam gjuhë të huaj, ja mbathëm jashtë shtetit,- u hodh nipi Pinxho Kapellës.- Ndaj më mirë të mësojnë këta shqip.

Çeçua tundi kokën dhe u kthye nga muhaxhiri afgan.

- Ore Kalli, s'të kam pyetur. Ke familje, grua, fëmijë?

- Këtu jo grua. Atje në Kabul 4 grua kam.

- Domethënë paske atje 4 copë, dashke edhe këtu, ë? - thumboi Çeçua.

- Po ti Çeço sa grua ke?

- Një kam, po e kam për vete...Ore, ato gratë tuaja ç'bëjnë atje, mo?

- Luftojnë, luftojnë me peticione e protesta. Unë topçi, po top jo.

- A, e ndritët ju me topa llastiku e mbetën ato,

- shtoi nipi i Pinxho Kapellës. - Po të ishit trima, qëndronit atje me gra e fëmijë të mbronit vatanin tuaj.

- Sa fëmijë ke, zotrote? - Pyeti hyzmeqar "shuli".



- 16 bambini.
- Marshallah. Një skuadër futbollit me gjithë rezervat, - tha Çeçua dhe ngriti faqoren e rakisë. - Ja një doli për ata "bambinit" e tu; Gëzuar!
- Po ne do bëjmë sehir, o Çeço. S'na dhe një pikë raki, - u hodh një kafshar. - Me çfarë ta ngremë të shkretën doli?
- Të gjithë morën nga një gavatë të vjetër me pak raki.
- Të kam gjetur, Kalli!
- Ëë, - ja bëri afgani, që nuk e kuptoi dollinë e "shulit".
- Ëngla m'u në byth, - ja priti Çeçua. - Të uron për "bambinit" dhe gratë e tua, që i paske më shumicë.
- A po, ejvallah, - tha muhaxhiri dhe ktheu gavatën me dhallë.
- Nesër do bënet qeveria e fshatit. Do viç edhe ti, - foli Çeçua.
- Unë them ta bëjmë "ministër të mbrojtjes", -

- qeshi nipi Sherifesë. - Apo nuk ja thonë këta për luftë!...
- Allah, allah, no, no luftë. Mua mbaj Çeço. Puna dua.
- Atë e di unë, - ja preu shkurt Çeçua. - Ti mund të rriç sa të duaç, po të mësoç shqip. E tha edhe "kryemisri" ynë. Bukë, kripë e dhallë kemi sa të dhjeç. Nashti informacioni mbaroi. Të gjithë nëpër vendet e punës.
- Ti Çeço njeri i madh. Hero nacional, - tha afgani. - Këtu ka qetësi, punë e bukë, jo "loqe"...
- Ka, o Kalli, ka. Po ti rregullo atë llafin; thuaj "llogje". Dëgjove? Dëgjova, thuaj. Ta diç mirë; në stanin tim ka Çeçua biçak. Na ka dalë nami për "dhisiplinë" e rregulla. Ndërsa "stanit të madh" po i bie "çatia" me gjithë tjegulla... Kështu ndodh kur e "ha mola" trarin "e gjatë" që i mban... Po ha, ha gjizë o Kalli. Gjiza të bën esëll...

# SATIRICAL POEMS

## OPORTUNISTI

Oportunisti ish komunisti  
Vjen i heshtur n"demokraci,  
Nuk i shteret kurrë durimi  
Për të punuar në fshehtësi.  
I pëlqen mënyrë e sjelljes  
Gojëkryçur, veshët n"shesh,  
Porsi hije e zezë e natës  
E gjen rrotull midis nesh.  
Në fushata e në mbledhje  
Me do Lista të përgjimit,  
Duke humb" si shurrë pule  
Nëpër kthinat e shërbimit.  
Sjellja e tij prej heshtaku  
Sa qyqare, po aq e mjerë,  
Në dëm t"popullit e Atdheut  
Të ngjallë krupë edhe vrer.  
Nuk e ngopi dot lakmia  
Për të qenë sa herë i parë,  
Vjen një ditë e i bënë roje  
Një flamur i zi mbi varr!

*Sevdail Hyseni – Spica metalike,  
Preshevë*

## LAKMIA

Gomarët e vjetër  
Kërkojnë samarë  
Shtyhen në mes vete  
Taxhi për të marrë  
Me dhëmbë të fortë  
Pwrtypen e përtypen  
Pse hanë në dy strajca  
Kurrë nuk koriten  
Madje secili prej tyre  
Në dukje më i vrazhdë  
Sikur janë të pa ngopur  
Me ushqime në grazhd  
Keni kullotur mjaft  
O gomarë kodosha  
Mos kërkoni shumë  
Ju ka kaluar moshë  
Edhe së shqelmuari  
Nuk po ndalen dot  
Gomarë do të mbeten  
Si dje, edhe sot

*Musa Ahmetaj, Dardanë*

## DY SHQIPTARË NË BERLIN

Sot u çova me mëngjes  
Një këngë t're për qef ta qes  
Që ta këndojë kush si mundet  
Në Fejzbuk kur t'i rrasë hundët!

Hajt një herë, thash, ta nis ditën  
Sikur Rrushja kur e rrokë sitën,  
Sa lash natën si kthinë të murgut  
Rashë kah portat e Brandenburgut.

E pyes veten mendjetrazuar:  
Je në ëndër a je zgjuar?!  
I ke parë a s'i ke parë  
Në Berlin bashkë dy shqiptarë?!!!

Dy shqiptarë kryeministra  
Që nuk lidhen me shtatë kapistra,  
Si pat thënë ai Ibra i ynë  
Kur e qiti n'shesh profecinë.

Shqiptarët lidhen këmbë e duar  
Veç n'Europën e bashkuar!  
Se i djegur ai Fishta i mbarë  
Vdiq pa i pa bashkë dy shqiptarë!

Dy shqiptarë në mes Berlinit,  
Mbeturinat e Leninit,  
A i hodhën me ngjall shpresë  
N'valë të Elbës n'valë të Spress-ë?

Më trand prapë zë i Gjergj Fishtës:  
Ruaju çun mos dil sernishtës,  
Ti nga ëndrra kenke çu befas  
Shqiptarët lu'jnë veç kukumsheftas!

Se kur zbresin ne Ballkan  
Atje bjen tjetër tupan,  
Shkunden bërryla e shkunden gju'j  
Kush kujt s'pari i ngul ku'j!!!

*Faruk Tasholli, Gadime - Lypjan*

## DIALOG I PËRJETSHËM

"- U plake, mike, u plake,  
Branë i heq ato çorape!  
- U plake, mik dhe tinë,  
Mbetë si kau në brinjë!"

- Kau iku e na la,  
Po unë prap të kam sevda!  
- Unë çorapet i heq vetë  
Po më bëre isharet\*!

- Pranë oxhakut jam kërcu,  
S'ndizet zjarri me një dru!  
- Ja ku jam, more lanet\*,  
Nuk u ngope me byrek!?

- Me byrek, me bakllava,  
Unë për ty do bëj dua\*!  
- Duan' bëje siç di vetë  
Se ka mbetur ca sherbet!

\*isharet- shenjë,  
mbyllje syri  
\*lanet- në kuptimin:  
i zgjuar, i shkathët  
\*dua- lutje

*Fatmir Musai, Elbasan*

## WORD WITH SPEC

Të lyerit me vaj, depërtojnë gjithkrah, pa zhurmë!

Dikush po e quan vendin tonë shkretëtirë, por sa e di unë, shkretëtirë pa rërë nuk ka. Këtu na e kanë vjedhur edhe rërën! (e huazuar)

Hajnat ordinerë e paqin veten në qafë. Do t'u shkojë jeta në zinxhirë (ari), në qafë, duar e këmbë!

Ne po mundohemi ta hamë të gjallë njëritjetrin e po ankohemi se tjerët na quajn kanibalë!

Nuk ka dert që gruri ka pasur rendiment të ulët. Në rast rreziku kapemi për kashte, jo për gruri!

Qeveritë përherë janë marrë më shumë me fjalë, e veprat ua kanë lënë popullit. Tani kur edhe populli po merret me fjalë, veprat ua kemi lënë të huajve!

Popujt që e quajtën veten popuj qiellor, ia prejnë vetes rrënjët që i lidhnin me Tokën dhe do të mbetën as në Tokë as në Qiell!

Po flitet se vrima në shtresën e ozonit po rritet! Nëse vazhdon të rritet edhe më tej, do të shndërrohet në vrimë të zezë. Ky është fat për shkencëtarët se do ta shohin nga afër.


Të shiturit, po i kushtojnë shumë vendit! Më lirë do të na kushtonin t'i blinim ne!

Tek ne gjithçka është artificiale, përveç budallalëkut që e kemi të lindur, dmth e kemi dhuratë nga natyra! (e huazuar)

Nuk po dimë t'i vlerësojmë sa duhet udhëheqësit tanë, para se t'i votojmë. Po na duken dele e po na dalin deshë!

Është thënë se shpëtimtari i botës vie një herë për sa të ekzistojë bota, por kjo nuk doli e saktë. Kjo po ndodh, sa herë po i shpallim zgjedhjet!

Në këtë botë gjithçka ndryshon me kalimin e kohës, pos marrëzisë!  
E ngriti flamurin e bardhë, pasi e mbuluan të



zezat!

Qenin e lejojnë të lehë, e mua nuk ma japin fjalën! (e huazuar)

Kur e flasë të vërtetën, nuk më dëgjon kush. Kur e flas të kundërtën, bëhen sy e veshë!

Si ai që dorëzohet në hapin e parë pas startit, si ai që dorëzohet një hap para cakut, janë humbës! Para nesh nuk foli asnjë fjalë. Kur e morën në polici, këndoi si bilbil!

Kur shkrova për lexues, nuk më lexoi kush. Kur thash: Nuk është për lexim, vërshaun lexuesit!

Kur gjyshi ishte në shtratin e vdekjes, ne qanim që po vdiste gjyshi, ai qante që po na lë ne në këtë botë!

Varfëria, dikujt vetëm i troket në derë e dikujt ia then derën! (e huazuar)

Njerëzit e mençur e kuptojnë me t'parën se nuk bënë të flasin kundër pushtetit, prandaj heshtin!

Nuk ka kuorum në sallë. I marrim mëditjet dhe takohemi sërish nesër!

Se nuk jemi koloni e askujt, pajtohen edhe kolonizatorët tanë!

I thanë, je në rrugë të drejtë e i ra kthesës drejt! Gjithçka blihet me para, edhe pse gjithçka nuk është në shitje!

Pushtetarët janë shkurtpamës. E shohin vetëm interesin e tyre!

# Quza's TikTok

(Popull i vonuar)

Është interesantë çfarë populli jemi! Ngutemi e nuk mbërrimë me kohë!

Orën e kemi njëmijë euro e vonesën një orë!

Kur e kalojmë rrugën njëkahëshe, këqyrim në të dy anët e rrugës, se ka mundësi që ndonjë i vonuar, të na bëjë copë-copë!

Varrimet i caktojmë në ora 13.00, dhe e bëjmë varrimin në ora 15.00, duke i maltretuar të gjallët, edhe pse e dimë se të vdekurit nuk i bëhet vonë!

\*

Njëri e donte shumë vajzën e vet. Aq shumë e donte, sa gjithmonë gjente arsye për t'u thënë jo mësitëve! Njëherë, i zënë ngusht, kërkoi ta vizitonte shtëpinë e kërkuesit të dorës së vajzës. Shtëpia ishte e mirë, asnjë behane nuk gjeti aty, por në një moment e pa një si kasolle të vogël në fund të oborrit dhe pyeti:

- Çka asht ajo kasolle atje?!

Babai i djalit tha:

- Nevojtoren e kemi atje!

Babai i vajzës mendoi që e gjeti arsyen për t'i thënë jo, dhe i a ktheu :

- Nuk muj me ta dhanë vajzën, se nevojtoren e paski larg!

I zoti i shtëpisë iu përgjigj:

- Nuk asht larg nëse nishesh me kohë, e si t'vonohesh, para hun've me e pasë, e ban mut!

*Abdyl Hajredini*

## From the satirical crater

HAJDE HIRRË! ...

I mbloodha një ditë mendët e të gjithë politikanëve tanë (me qykë t'zorit), i futa në t'pî (enë prej druri ku tundet qumështi për t'ia nxjerrë tlyntë), i tunda mirë e thash, pale çfarë yndyre a produkti do të më dalë?!!! E pasi i tunda e i tunda, i derdha në një enë të shtrirë. Kur... çka doli? ... HIRRË!!! Kokërr tëlyni, fare! Krejt hirrë! Bre që i kam dëgjuar disa duke thënë: "I ka mendët hirrë"! E pra...

Hajde hirrë! ... Hajde hirrë! ...

DIOPTRIA DHE PËRMASA E PROBLEMIT

Shumë politikanë e analistë duhet të kenë kujdes që të kontrollohen shpesh te oftalmologu se, helbete, u është çrregulluar dioptria dhe kështu gjërat i shikojnë mbrapsht e vrugt ose nuk i shohin në përmasa reale!

FLENI DATHË!

Po shumë-e-patrioti kish pas qenë n'kët' Kosovë!!! Sot u erdhi dita të dalin në skenë e të rrahin gjoks: Ja ku jemi! Jaaa... nuk e paskështa

ditur!!! Siç po duket, deri tash paskan qenë tepër modest e kanë qëndruar të mëshehur skutave të përditshmërisë?!!! Shumë mirë! Fleni dathë!

BËJE ZOT ËNDËRR!

Në Kino-Studio e Qytetit është duke u xhiruar filmi "Gjak e lak me vëlla".

Skenari: Dreqi;

Regjia: I biri i Dreqit;

Aktorët: Rrugaçë, pa akademi të kryer të filmit; Përmbajtja e filmit: Çka është duke ndodhur me ne...? Bëje Zot ëndërr!

KRIZA PËR BALTËN

Në Shqipëri dhe në Kosovë s'ka më baltë as për ilaç. E kemi harxhuar duke ia hedhur njëri tjetrit në fytyrë!

QORR-POLITIKA

Mendimi dhe veprimi politik i cili nuk ta prodhon rezultatin e pritur për arritjen e ndonjë qëllimi, nuk mund të emërtohet ndryshe pos QORR-POLITIKË.

Fadil Rrustemi

## HUMOROUS APHORISM

Jam shumë i bindun që n'alkohol ka hormone  
t'femave , se kur pi flas shumë, edhe nuk di me  
vozitë!

Mos t'ish kan Policia e Kosovës prapë patën mi  
rrehë k'ta t'KFOR – it!

Imagjino, shqiptari me zbulu naj ligj n'fizikë!  
Ligji i Shabanit, Ligji i Hamdisë ose  
Konstanta e Kadrisë, ...

Ban'nu kishe jemi njerëz, përderisa shkenca ta  
vërtetoj t'kundërtën!

Njoh njerëz që flasin shumë e s'thojnë kurgja, dhe  
njerëz që s'flasin hiç e thojnë shumë!

Po t'mos k'ndonte gjeli n'ora 5 n'mëngjes, pula ja  
kish futë gjumë deri kah 10.00 a 11.00!

Krejt njerëzit diqysh m'g'zojnë. Do kur t'vinë, do  
kur t'shkojnë!

A e keni edhe ju dikun n'shpi nji kесе me plot kесе  
mrena n'atë kесе?

Ma lehtë rri deri n'6, se çohna n'6!

Qeky ose ka me na çitë n'dritë ose ka me naj  
shkymë dritat!

- Zemër! Nuk po muj me gjetë kërkun çajin.  
- O trullan! Krejt sakat je. K'qyre n'kuti t'kakaos  
shkrinë „Krypa“. Aty e ki çajin!  
- E sheqeri , n'cilën kuti?  
- Sheqeri asht n'kuti t'vegetës. Shkrinë „çaj“,  
mrena ka sheqer!

Shteti e mafia janë t'njejta, veç mafia asht e  
organizue me.

Mos rrejë, mos mashtro, mos vjedh! Shteti nuk do  
konkurencë.

Kur po çohna n'mëngjes, as mobili jem s'po m'njeh  
pa e pi kafen e dytë!

Burr asht ai i cili e len gruen pa tekst!

Mos t'ishin kanë gratë, na hala kishim jetu nëpër  
shpella!

- Kah asht rruga për spital?  
- A p'e sheh atë kthesën atje?  
- Po!  
- Eh! Ti futja drejt!

Sot shkova n'punë. S'un gjeta ven me parku kerrin  
e  
u ktheva n'shpi! Thash, paskan boll puntorë, masi  
parkingi te koka plot!

- Qysh ke mujtë gjithë këtë budallaki  
me ba për një ditë?  
- Jam çu herët – tha!

Erdh edhe kjo kohë, kur i meçmi hesht, budalla  
flet!

Asht pakica që e infekton shumicën, tani krejt  
diqysh t's'mutë po dalim!

Tu nejtë qaty m'kish zanë gjumi. Pashë anërr  
kishe jamë n'punë. Kur m'dul n'gjumi,  
përnime n'punë isha kanë!

Gjanat ma me ran'si që i kemi m'su n'shkollë janë,  
që  
gjanat që janë me ran'si nuk m'sohen n'shkollë!

Me alkool nashta nuk i zgjidhë problemet, veç as  
me tamël jo!

Kur i ka maru Zoti burrin edhe gruen, asht largu  
nja dy-tri metra edhe i ka k'qyrë. K'qyr burrin, qyr  
gruen, k'qyr apat burrin, k'qyr gruen, i kthehet  
grues e i thotë: Ti duhesh m'u shminkatë!

Herët a vonë ke me kuptu, që vonë e ke kuptu!

M'tha njani:

- Ke gjithmonë mendim t'kundërt me mu!

I thashë:

- Në të kundërtën do ta kishim të dytë gabim!

Shumë po bahna nervoz kur p'i shoh k'ta gjerman't qysh s'bahen hiç nervoz. Tani edhe ma shumë po bahna nervoz!

Njeni prej emisioneve që ma prishë ditën, asht emisioni "Kush ta ndreq ditën?"

Nji pacient n'psikatri e shkrunte nji letër. Vjen doktori dhe e pyet:

- Kujna po i shkrunë letër?

- Vetit – përgjigjet ai!

- E çka po shkrunë!?

- Nuk m'ka ardhë hala ooo trullan – ja kthen!

Njeriu arrinë në një pikë, ku patjetër fillon me kryerresht!

Jeta plot sfida. Nuk di njeri cilën me zgjedhë!

Kaniherë kur po menohna, po thom, ma mirë hiç mos m'u menu!

Shkova n'komunë me nxerrë nji dokument. Tu pritë aty, erdh njani e m'veti:

- Për naj dokument a?

- Jo - i thashë! - Jam t'e pritë autobusin!

Të gjithë ne kemi lindë njer'z. Disa prej nesh edhe kemi mbetë të tillë!

Kur p'i ban njeri do vjet, po duhet me pasë kujdes n'tri gjana: E para, mos me harru, eeeee...ato dy tjerat nuk po m'kujtohen për momentin!

Krejt i kam harru qato momentet e paharrueme!

Nuk keni faj që nuk pajtoheni me mendimet e mia. Shpesh po kam problem edhe vet!

- A asht Afrika larg - e veta njanën?

- Jo – tha - se e kam nji kolege zezake që vjen me bicikëll n'punë!

- Ku je !?

- Qe qetu n'kafe , t'e pi ni birra!

Të gjithë ata që i kanë ka dy f'tyra, me jau dhanë ka nja k'tyne që s'kanë hiç, secili e kish pasë ka nja!

Populli mashtrohet, t'e bindë që nuk je t'e mashtru!

Kur nisem herët për punë, krejt semaforat çelë. Kur nisem vonë, krejt m'shelë!

Ngrohja globale asht shumë ma e parrezikeshme se budallakia globale!

Po bi shumë vonë me fjetë e po çohna shumë herët. Jam tu tutë që naj ditë, veç kur ta zateti vetin dikun n'korridor!

Kur po vjen Dita Ndërkombëtare për me keshë, kur p'i shoh do, po m'kahet!

Me k'qyrë holl e holl, parja nuk asht me randësi, po shumë me randësi!

Po m'doket e keni harru matematikën, se kush hesap s'po m'ban!

Personi që punon në radio, logjikisht duhet të quhet radiator!

Masi t'hjeken vizat, kthehna n'Kosoveë, se bahet kallabllik n'diasporë!

Mentë po m'mirren tu u sjellë mirë me njer'z!

Krejt jemi kapak t'lujtun. Ai që s'e pranon ashtë edhe ma i lujtun!

Ka heshtje që m'ka lanë mbresa ma shumë se disa biseda!

## ANECDOTES FROM THE POPULAR TREASURY

### LE T'JA ÇET NI QASI VIAGRE PASULIT

- Uh bir, sa pasul t"mirë kishe ble se ish rritë fort, fill me ni valë!

- Pasuli ashtë si ai i maparshmi, po ja kam çitë ni viagër.

- Shka ashtë ajo viagër o bir?

- Viagra blehet n"barnatore edhe secilit sen qe ja çet, e rritë

- Shkova m"i kallxu Zizës le t"ja çet ni qasi viagre pasulit, se edhe ajo po ankohet se nuk po rritet pasuli kur po zihet!

*Ismet Tahiraj, Skënderaj*

### PO M"DUHET ME HANGËR BUK NJIZET HER N'DITË

Njëni shkon te mjeku. Mjeku, masi e kontrolloi, i tha:

- Duhet me lân duhanin! Ky kishte qenë duhanxhi i fortë e e lutë doktorin:

- Aman, a ban me pi veç një cigare mas buke?

- Ban- i thotë mjeku, - nëse ma jep besën që e pi veç një cigare mbas buke.

- Besa te"koftë - i thotë ky.

Mbas një kohe e takon mjeku e l thotë:

- A po e mban besën qysh jemi marrë vesh? – Po!

Veç po m"duhet me hangër bukë njizet herë n'ditë - i përgjigjet!

*Muzafer Osmani, Ferizaj*

**Nderim Isufi**



## A MU, A ME A BE

Njani i nji katuni të Llapit ish kanë fukare deri qaty. I kish pasë dy djel. Djelt e tij shkojshin me nji kali e vidhshin, herë naj viç, herë naj edh, herë naj kingj. Si ju soske mishi ata dilshin e vidhshin diçka e veç mish hangshin. Nji ditë ju kish pas thanë djele që, kur të vini, me ba me kanë naj musyfir n"odë, unë ju veti: „A mu, a me, a be? E ju në paçi marr' naj viç më përgjigjini me „Mu“, në paçi marrë naj edh më përgjigjini me „Me“ a në paçi marrë naj kingj më përgjigjini me „Be“.

Kështu ata shkojshin e vidhshin sa herë që ju soske mishi. Nji ditë shkojnë me vjedh në ni katun me kali. E lanë kalin si ngat nji gardhi edhe shkojnë me vjedh nji kingj, po i hetojnë çobatë e t"i kokrojnë. Ata ikun, po ju jetë kali atje. Kur shkojnë të shpia, hinë n„odë. Aty ish qillue nji musafir. Po i vetë baba i tyne: A mu, a me, a be? I pëgjigjet djeli i madh:  
-Valla mor babë, as mu, as me, as be, po hi, hi, hi, met atje!

*Tregoi: Alush Imeri, Metehi*

*Shënoi: Shaban Pllana, Besianë*

## NUK FLEJ VET SE TUTNA

Axhës Zymë, i diq plaka. Kur u kry e pamja, djemtë masdarke deshtën me shku n"dhoma t"veta me fjetë.  
- Ku po shkoni – ju tha?  
- Me fjetë o babë.  
- E unë shka me ba?  
-Bjer edhe ti,flej!  
-E jo vallahi, me ra kallli vet nuk muj, se tutna me flejtë vet. Dikush pi ju dyve duhet me fjetë për natë me mue. Djemt e banë me ren me fjet me ta. Dikur u lodhën, i ranë gurit e drunit e ja gjeten ni grue. Masi u martu axha Zymë, si hangshin darkë, ju thojke djem"ve: - Shkoni fleni! Shka po pritni? Duhet me punu, se t"gjell"t lypin me hangër!

*Hajrush Idrizi, Ferizaj*

## N"QIREQ GJEGNA, BAHNA SHKRUM

Njani e kish pas vet mulla Ademin e Biçecit:  
- Hoxhë efeni! Me ba me m"thirrë naj grue për dashni e me m"përbe n"riza t"Zotit, a duhet me shku?  
- Po- tha! Rizaja e Zotit është e madhe!  
Ky far burri i tha ni shoqit t"vet: - Heheheeeee, a t"thash çu ban?  
Po hoxha s"e la me kaq, po e veti:  
- Me ba me t"dalë ni grue qetër n"udhë, edhe me t"përbe: - Pashë rizanë e Zotit, mule se m"ka ra f"mija n"grupë t"qireqit, a je burrë çu shkon n"atë zarm?  
- Joooo bre hoxhë! Aty gjegna, bahna shkrum?!  
- Eeeee, masi q"aty s"ta manë me shku, at"herë mos shko as te çajo gruja çu t"ka thirrë me ba dashni "për riza t"Zotit"!

*Milaim Mezin, Biçec - Kaçanik*

## ME KTHY EDHE NJIHER , MA ZGATNI HALA

K"tyne here për martesë u dashke me çu harxh për qejzimin e nuses.  
Njani, kur shkoj me da vade, miku ia dha nji letër shka me ble, para se me da vaden, po lista e harxhit ish kanë shumë e gjatë. Ky e luti me shku me vetë t"shoqen për me shkurtu pak listën e harxhit, po shoqja ish kanë e untë e i thotë burrit:  
- Ktheja letrën edhe thuj, krejt qeto duhen, plus me ja shtu edhe 300 qese.  
Atëherë, ky që kish shku me da vade, tha"  
- Po e marr letrën, se me kthy edhe njiherë, ma zgatni hala!

*Ismet Smakaj, Abri Skënderaj*

## ATA DESIN PREJ ETJES

Tu folë me Selën, e veta, a thu, qeta që po desin t"ri, mos po desin prej alkoolit?  
- E pse po desin ata që nuk pinë – m'u përgjigj me pyetje!  
- Eh! Ata desin prej etjes – ja ktheva!

*Imri Musliu, Ferizaj*

## SKANDI

Përpiloi Azem Çerkini	Gjini artisti- ke	Ozon	Molib- deni	Fryma	Kryeq. i Ban- glad.	Lum në Austri	Amper		Bash- tingullore	Dy zanore shqipe	Pjesë e ligjerat (Sh.Pash- a)	Pjesë e Kos- tunit	Zanore e bashk.	Film i K. Gavrasit	Paemë rsitë
Gjini artistike								Gjini etnog Jodiale							
Atom		Liman në Algjeri					Metër		Haxhi ..Priz. Neon					Azot Ore, or	
Shkronj greke			Akil Koci Hadri			.... Bella Neon				Radius Fosfor Metri			Molib- deni Qytet n Francë		
Aktorja Lupino				Mallkimi kishtar Njësi e vj. peshe								Fig. Gjeo. Zvarrani k			
Ec para					Gjini art. ...Peç							Çoban Qytet yni			
Amper		Shkova Sahati				Felish Kampion				.Koner Shko				Masa Ajri (Huaj)	
Toriumi			Jo sin- teza Atom										Përem. Vetor Miop		
Vendkal. mbi lum				Shkr. Lat. Akt humo- ri (sk).			Bashkët ing. Fe		Ndajfolje vendi Emër m			Legjend Vend në Silov			
Radiumi			Split Floriri			Laden ...es Salam				3,14 Eliot ...			Notë sol. I pari		
Ameba		Agata Kristi Dioda			Drejtues fakulteti Neon						Zë (pop) Litri			Tempo Induksio ni	
	Qytet yni Gjini artist							Melodi a Shegë							Kryeq tet në Afrikë
Belgjika		Ismail Qemali Trim			Aerop. në Tiranë Babë						Litiumi Burimi			Tempo Krah. E iona	
Adem Demaçi			Inter, Alt Bor			Tomas Një sëmundj e				Folje ndihm. Thirrje tel..			Më (pop) Denar		
Ishull kroat				Ke, tek Trim			Radio Pajtimi (huaj)		Flori Rek. Në xhudo			Ranada n Soc. Ali			
Karbon Induks.			Lloj bime Varg					Sheso Em. M.					Tantal Legjend a		
Oksigjeni		Përgjed hje												Nitro Alma	
Emr f.						Bakër Bash				Jetë fshati Mëzat					
Mon. Europ.					Malësor Midis						Kisti (mbr) Jo				
Numer tek				Muret Molibd.								Për. Pron.			
Albert Ainshtain			Parafja lë			Masajos hi				Shkr. Latine			Antonio Vivaldi		
Tempo		Prodh. Qumshiti					Inter		Emër m.					Ameba	